



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Oraovac/Municipal

Assembly Rahovec

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam

Department of Economy, Development and Tourism

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme


Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 1384 Br. prot. 26.04.2019

Për:	Z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës
Nga:	z. Artan Asllani-Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Lënda:	Raporti i punës Janar-Mars -2019

RAPORTI I PUNËS PER PERIUDHEN JANAR-MARS -2019, I DREJTORISË PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM JANAR-MARS 2019 Z.ARTAN ASLLANI

Organogrami i Drejtorise per Ekonomi Zhvillim dhe Turizem



Aktivitetet e përgjithshme:

Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, ka kryer një varg të detyrave dhe aktiviteteve të parapara për këtë periudhë raportuese.

Takim pune me Auditorët e jashtëm ku më kanë dhënë rekomandime për punën dhe dobësitë që e kanë shoqëruar këtë drejtori gjatë vitit 2019. Të gjitha rekomandimet e auditorit janë marrë seriozisht, janë ndërmarrë masa që të gjitha këto vërejtje dhe të gjetura të auditorit të evitohen, dhe të përmirësohen në vitin 2019, dhe në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019.

Projekti i fituar: nga Ministria e Zhvillimit Rajonal "Asfaltimi i Rrugës NE Zonen turistike "Maja e Shkodranit"- Rahovec në vlerë prej: 95,000.00€

- Takim me shfrytëzuesit e pronës së pa luajtshme komunale në lidhje me borxhet që i kanë komunës së Rahovecit.

- Vizita bizneseve te komunës se Rahovecit.
- Takime me bizneset dhe qytetaret e fshatrave Opterush, dhe Zoqisht, ne lidhje me themelimin e Zonës Ekonomike.
- Takim pune ne Ministrin e Tregtis dhe Industris, per procedurat rreth kompletimit te lendes per licencim te Zonës Ekonomike.
- Takime me AZHR-jug ne lidhje me sensionin informues per bizneset e komunës se Rahovecit per aplikimin ne MZHR-ës.

Për periudhën Janar- Mars 2019 ne Zyrën e Qendrës komunale për regjistrimin e bizneseve (Q.K.R.B) janë te regjistruara ne protokoll- biznese të reja, janë shqyrtuar gjithsejtë lëndë.

N.R.	PËRSHKRIMI	NUMRI I LËNDËVE
1	Biznese të Reja	25
2	Ndryshime në Biznese	18
3	Informata per Bizneseve	20
4	Shuarje të Bizneseve	13
5	Certifikate NUI dhe info.(dt.te Re)	0
6	Duplikat Certifikatë	1
7	Vërtetim	1
8	Konfirmim	3
9	NUI Certifikatë	148
	Gjithsej:	229

Zyrtari për zhvillim

Duke u bazuar në bazën e shfrytëzimit të lokaleve dhe pronës komunale për periudhën **Janar-Mars- 2019**
 - Pronat komunale të dhëna shfrytëzim afatshkurtër nga komuna e Rahovecit janë të gjitha të evidentuara dhe të kontraktuara, gjithsejtë janë njëzet e tetë (29) prona komunale me kontrata dhe një (1) pronë me aneks kontratë.

- Evidenca e të hyrave dhe ngarkesës së qirasë të lokaleve afariste dhe pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt.

- Të hyrat nga qiraja për periudhën Janar - Mars dhe saldoja është paraqitur në tabelën më poshtë

1	Të hyrat nga qiraja Janar - Mars 2019	12,414.50 €
2	Saldo ja janar - mars 2019	42,015.50 €

- Pëlqimet e punës për bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit për periudhën Janar - Mars 2019 janë: nëntëmbëdhjetë (19).

-Anëtar nëpër komisione të ndryshme me vendim të Kryetarit.

- Pranimi dhe shqyrtimi i ankesave nga palët dhe bizneset e komunës së Rahovecit

Ndërsa për këtë periudhë kohore kemi menaxhuar mjaft mire edhe me menaxhimin e aseteve komunale ku janë kryer këto pune:

Realizimi i objektivit për vitin 2019 deri ne 31.03.2019 është realizuar 31 %

Deri ne fund te muajit mars kryesisht jemi marrë me rexhistrimin e bizneseve prej librit

te vitit kaluar 2018 ne bartjen në librin 2019 te bizneseve aktuale dhe rexhistrimin

e bizneseve të reja ku edhe është përfunduar kjo detyrë .

Kemi pasur edhe shumë kontakte me bizneset lidhur me analizimin dhe shqyrtimin e ngarkesave për vitin aktual 2019.

Gjithashtu i kamë shqyrtuar dhe ekzekutuar ne program të gjitha vendimet e komisionit për ankesa të cilat janë bërë në këtë periudhë.

Deri ne këtë periudhë kryesisht janë përfunduar mbi 80 % e Aktvendimeve dhe ka filluar shpërndarja e tyre nëpërmjet postes.

Deri me datën 25,04,2019 janë shpërndare mbi 300 Aktvendime

Janë lëshuar mbi 115 fatura për pagesë te taksës afariste ndërsa janë kryer - paguar 101 fatura .

Te hyrat ne taksen afariste komunale për muajin Janar-Mars janë 17,467.00€